

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6444
E mërkurë, 20 tetor 2021
çmimi 0.40 €

Veriu sërish përplas pozitën dhe opozitën në Kuvend



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI EVROPIAN KA PARAQITUR RAPORTET E PROGRESIT PËR VENDET E ZGJERIMIT

RAPORTI I KE-së: KOSOVA T'I QASET ME PRIORITET ZBATIMIT TË AGJENDËS EVROPIANE



Komisioni Evropian të martën ka paraqitur raportet e progresit për vendet e zgjerimit. Në paketën e zgjerimit, që përfshin edhe raportet vjetore të progresit për vendet në këtë proces, ku përfshihet edhe Kosova, është gjetur një përparim i kufizuar në shumicën e proceseve. Komisioni Evropian u bënë thirrje institucioneve të Kosovës që t'i qasen me prioritet zbatimit të agjendës evropiane. Raporti i progresit ka theksuar se një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë është urgjente që këto dy vende të përparojnë në rrugën e tyre drejt BE-së

KUVENDI MIRATON NË PARIM PROJEKTLIGJIN PËR DËRGIMIN E FSK-së JASHTË VENDIT



MISIONI I BE-së: VLERËSIME POZITIVE PËR ZGJEDHJET, PËRJASHTUAR KOMUNAT SERBE

AKTUALE



SHANTAZH I SËRISHËM PËRMES ASOCIACIONIT

KOSOVA REGJISTRON NJË VIKTIMË DHE 17 RASTE TË REJA ME COVID-19

NË KLINIKËN E RADIOLOGJISË KRYHEN 127 MAMOGRAFI

EKONOMI



POZITA DHE OPOZITA PËRPLASEN NË KUVEND PËR GAZSJELLËSIN

PRESIDENTJA TAKON AUDITOREN: PARAJA PUBLIKE TË MENAXHOHET SI DUHET

SPORT



LLAPI SHKATËRROI ULPIANËN, FITOJNË PRISHTINA DHE DRITA

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

PARTITË POLITIKE I KTHEHEN KUVENDIT TË KOSOVËS

Veriu sërish përplas pozitën dhe opozitën në Kuvend

Partitë opozitare e kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës për aksionet e fundit të policisë në veri. Sipas tyre, këto aksione kanë ndikuar në përkeqësim të gjendjes sa i përket sundimit të rendit dhe ligjit në atë pjesë. Këto pretendime të opozitës i ka hedhur poshtë kryeministri Albin Kurti, i cili ka thënë se tani ka më shumë se kurrë siguri dhe shtet ligjor në veri të vendit

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 TETOR - Partitë opozitare e kanë kritikuar qeverinë për aksionet e policisë në veri të vendit edhe në seancën e Kuvendit që është mbajtur të martën. Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se si rezultat i këtyre aksioneve të pamenduara mirë është përkeqësuar gjendja e sigurisë në veri. Duke folur në Kuvend për dy aksionet e Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës lidhur me zbatimin e reciprocitetit për targarat me Serbinë dhe për luftimin e kontrabandës, Haradinaj ka thënë se Kosova pas këtyre dy aksioneve është më e dobët në këtë pjesë të vendit. “Kemi parë dy aksione policore në veri të vendit dhe pas këtyre dy aksioneve ka ndodhur përkeqësimi i gjendjes sa i përket rendit dhe ligjit në siguri dhe dobësimi i shtetit ligjor. Pas dy herëve që ka operuar Kosova në veri me policinë e vet, të dy herët kemi dalë të dobët. Besoj se të gjithë ata që janë të fushës së sigurisë mund ta japin këtë vlerësim. Herën e parë na është mbajtur policia peng në pikat doganore dhe një polic i sëmurë nuk ka mundur të bartet dhe të shkojë në spital. Herën e dytë policia jonë ka

arritur mjaftueshëm të jetë në konflikt me grupet kriminale”, ka thënë Haradinaj.

Më tej, ai ka thënë se këto aksione në veri të vendit janë bërë me qëllime të caktuara. “Aksionet po bëhen qëllimshëm për ta dorëzuar veriun, sepse është projekt diku. Nuk e di pse ndodh kështu, por mund t’ju them se ata që merren me këtë situatë e dinë se Kosova është më e dobët në veri pas këtyre dy aksioneve. Kërkoj sqarim të detajuar pse duhet të dobësohet shteti ligjor në veri pas këtyre proceseve që i kemi kaluar. Derisa u paguhet rryma në veri, pse duhet policia të mbahet peng prej grupeve kriminale? Pse duhet të merremi vesh me ata për t’u tërhequr? Pse kur shkojmë të operojmë përballlemi me ta?”, ka pyetur Haradinaj.

Pretendimet e liderit të AAK-së i ka hedhur poshtë kryeministri Albin Kurti.

Ai ka thënë se tani veriu është më i sigurt se kurrë më parë. “Asnjë barrikadë nuk ka në veri. Kjo pjesë ka qenë e rrezikuar atëherë kur deputeti Haradinaj e priste në zyrë kriminelin Millan Radojeviq. Rreziku ka qenë nga marrëveshjet gjentelmene me kriminelë. Pra veriun nuk e rrezikon policia. Fjala e deputetit Haradinaj është sulm ndaj moralit të policit”, ka deklaruar Kurti.



Shefi i qeverisë ka vlerësuar se morali i Policisë së Kosovës kurrë nuk ka qenë më i fuqishëm. “Kot e keni që po sulmoni, z. Haradinaj. Morali i policit është shumë i lartë dhe i paprekshëm. Kurrë morali i tyre s’ka qenë më i fuqishëm”, ka deklaruar Kurti.

Kurse deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka folur për reagimet e opozitës lidhur me aksionet e zhvilluara në veri të Mitrovicës. Ajo ka përgënjeshtuar akuzat e partive opozitare që këto

aksione janë bërë qëllimshëm në prag të zgjedhjeve lokale. Kusari-Lila ka thënë se këto aksione janë vazhdim i punës së mirë të qeverisë. “Punët e Qeverisë dhe të Kuvendit nuk presin, ato duhet të vazhdojnë pa marrë parasysh procesin zgjedhor lokal. Ky kabinet qeveritar gjatë këtij procesi zgjedhor dha edhe një shembull dhe një standard të ri për pjesëmarrje në zgjedhje lokale. Prej mosshfrytëzimit të resurseve qeveritare deri te mesazhi dhe korrektësia

politike, gjë e paparë deri më tani në Kosovë”, ka deklaruar Kusari-Lila.

Javën e kaluar autoritetet në Kosovë kanë ndërmarrë një aksion anti-kontrabandë në disa komuna të vendit, përfshirë atë të Mitrovicës së Veriut.

Ky aksion është përcjellë me protesta të dhunshme të serbëve lokalë. Në përleshjet midis policisë dhe protestuesve janë lënduar 20 veta, në mesin e tyre edhe zyrtarë policorë.

Kuvendi miraton në parim Projektligjin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit



PRISHTINË, 19 TETOR - Me 65 vota për Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim Projektligjin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit.

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka paraqitur Projektligjin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit. “Duke qenë se rritja e interesit dhe bashkëpunimit me vendet partnere është e nevojshme për integrimin e FSK-së jashtë vendit, kërkoj nga deputetët miratimin e këtij projektligji”, ka thënë Mehaj.

Deputeti i LV-së, Enver Dugolli, ka thënë se Komisioni për Çështje të Sigurisë ka

shqyrtuar këtë Projektligj, duke shtuar se i plotëson kushtet e parapara.

Deputeti i PDK-së, Hysen Berisha, ka shprehur mbështetjen për këtë projektligj, por që ka pasur dy vërejtje.

Deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj, ka thënë se në parim do ta mbështesin këtë projektligj duke parë rëndësinë që ka.

Ndërkaq deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka thënë se presidentja duhet të njoftohet me vendimin e qeverisë dhe të jetë në harmoni me Kushtetutën e vendit.



KOMISIONI EVROPIAN KA PARAQITUR RAPORTET E PROGRESIT PËR VENDET E ZGJERIMIT

Raporti i KE-së: Kosova t'i qaset me prioritet zbatimit të agjendës evropiane

Komisioni Evropian të martën ka paraqitur raportet e progresit për vendet e zgjerimit. Në paketën e zgjerimit, që përfshin edhe raportet vjetore të progresit për vendet në këtë proces, ku përfshihet edhe Kosova, është gjetur një përparim i kufizuar në shumicën e proceseve. Komisioni Evropian u bënë thirrje institucioneve të Kosovës që t'i qasen me prioritet zbatimit të agjendës evropiane. Raporti i progresit ka theksuar se një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë është urgjente që këto dy vende të përparojnë në rrugën e tyre drejt BE-së

PRISHTINË, 19 TETOR - Komisioni Evropian (KE) ka paraqitur raportet e progresit për vendet e zgjerimit të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) si dhe Turqia. Serbia dhe Mali i Zi tashmë kanë nisur procesin e negociatave të pranimit, me Malin e Zi që ka hapur të gjithë kapitujt në këtë proces. Turqia po negocion gjithashtu anëtarësimin në BE, megjithëse në marrëdhënie të tendosura me institucionet e Brukselit. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë në pritje të hapjes së negociatave. Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova

janë në fund të listës sepse janë të vetmet vende që kanë perspektivë evropiane, por ende nuk kanë statusin e kandidatëve për anëtarësim në BE. KE-ja publikon këtë raport një herë në vit dhe tregon situatën në të gjitha fushat kryesore, ku reformat janë të nevojshme që këto vende të përparojnë në procesin e integritimit evropian. Kosova duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe të bëjë përpjekje të tjera substanciale për "zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të kaluara" të arritura në kuadër të dialogut me Serbinë dhe të "kontribuojë në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të

obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", ka theksuar Komisioni Evropian në raportin e progresit. Sipas KE-së, një marrëveshje e tillë është urgjente dhe thelbësore në mënyrë që Kosova dhe Serbia të mund të përparojnë në rrugën e tyre drejt BE-së. Raporti ka theksuar se jostabiliteti politik dhe pandemia ndikuan në përparimin sa i përket zbatimit të agjendës së reformave evropiane të Kosovës që, sipas dokumentit, ka qenë i kufizuar. Prandaj Komisioni Evropian u bënë thirrje institucioneve të Kosovës që t'i qasen me prioritet

zbatimit të agjendës evropiane. Raporti i progresit për Kosovën thekson jostabilitetin politik në Kosovë. Aty përmenden edhe zgjedhjet parlamentare të shkurtit dhe formimi i Qeverisë së Kosovës në muajin mars, por theksohet se në pjesën më të madhe të periudhës që përfshin ky raport, ka pasur një "atmosferë polarizuese politike". KE-ja, po ashtu, vë theksin te situata në veri të Kosovës sa i përket korrupsionit, krimit të organizuar dhe kushteve për lirinë e shprehjes dhe thuhet se situata në këtë pjesë është ende sfiduese. Bashkimi Evropian thotë se Kosova ka disa nivele të përgatitjes në luftën kundër korrupsionit, por që janë në fazë të hershme. "Gjatë periudhës së raportimit është bërë përparim i kufizuar, përfshirë edhe hetimet dhe gjykimi i rasteve të nivelit të lartë", thekson KE-ja. Po ashtu, në luftën kundër krimit të organizuar thuhet se është bërë përparim i kufizuar. Komisioni Evropian, megjithatë,

tha se Kosova ka bërë përparim në luftën kundër terrorizmit, "veçanërisht për rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre". Megjithatë, Komisioni Evropian ka kritika për sistemin gjyqësor, pasi administrimi i drejtësisë vlerësohet se vazhdon të jetë "i ngadalshëm, joefikas dhe i ndjeshëm ndaj ndikimeve politike". Si pikë pozitive është parë Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Planin e Veprimit që u miratua në gusht të vitit 2021. Por, synimet e Kosovës për të bërë veting në gjyqësor vetëm një herë janë parë me "shqetësim" nga KE-ja. Në raport, po ashtu, flitet për përparimin që ka bërë Kosova sa i përket përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe rritjes së investimeve në energjinë e ripërtërishme, por "burimet e energjisë me bazë në qymyr vazhdojnë të jenë shqetësuese". KE-ja sërish ka thënë se reforma në administratën publike është urgjente. Sa i përket lirisë së shprehjes,

raporti i KE-së thotë se Kosova ka një nivel të përgatitjes dhe ka pluralizëm të mediave. Megjithatë, ka shqetësime lidhur me fushatat e shpifjes, kërcënimeve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve. "Mungesa e vetëfinancimit të qëndrueshëm, të përkeqësuar edhe më shumë nga pandemia Covid-19, i lë mediat e ndjeshme ndaj interesave politike dhe biznesore. Transmetuesi publik, po ashtu, është i ndjeshëm ndaj ndikimit politik dhe duhet të gjendet një zgjidhje sa i përket financimit të tij", thuhet në raport.

Serbia kritikohet për luftën kundër krimit dhe korrupsionit

Në raportin për Serbinë, pos vlerësimeve për kapitujt që analizon Komisioni, vend ka zënë edhe dialogu për normalizimin e raporteve me Kosovën. "Sa i përket normalizimit të raporteve me Kosovën, dialogu i lehtësuar nga BE-ja ka vazhduar me takimet në nivel të lartë më 15 qershor dhe 19 korrik të vitit 2021 si dhe tri takime të kryenegociatorëve. Gjatë periudhës që përfshin raportin, të dyja palët kanë emëruar kryenegociatorët e ri dhe ekipet negociuese" thuhet në raport. "Serbia duhet të bëjë përpjekje të tjera domethënëse për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve nga e kaluara dhe të kontribuojë në arritjen e një marrëveshjeje për normalizimin gjithëpërfshirës, ligjërisht obligues të raporteve me Kosovën", shtohet në raport. Sa iu përket raporteve me vendet fqinje thuhet se "Serbia në përgjithësi ka vazhduar të jetë e përkushtuar për bashkëpunim me vendet fqinje nga procesi i zgjerimit dhe vendet e Bashkimit Evropian". Për raportet me Malin e Zi thuhet se kanë qenë të tensionuara. Serbia ka shënuar vetëm "përparim të kufizuar" në luftë kundër korrupsionit dhe krimit

të organizuar. Problem është theksuar sidomos numri i vogël i dënimeve përfundimtare dhe konfiskimit të pasurisë për personat e përfshirë në krim të organizuar. Komisioni Evropian në këtë raport të progresit shprehet i shqetësuar edhe për vazhdimin e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe në përgjithësi me gjendjen e lirisë së shprehjes.

Raporti i progresit konstaton se sjellja e Serbisë në përshtatje të qëndrimeve me BE-në në politikën e jashtme mbetet e pandryshuar. "Një numër veprimesh të Serbisë kanë shkuar kundër qëndrimeve të BE-së në politikën e jashtme. Në vitin 2020 përshtatja e Serbisë me deklaratat relevante të përfaqësuesit të lartë në emër të BE-së dhe vendimet e Këshillit ka qenë 56 për qind, por është rritur në vitin 2021 në 61 për qind", thuhet në raport.

Serbia e ka statusin e vendit kandidat nga viti 2012, ka nisur negociatat e anëtarësimit në vitin 2014, por deri tash ka hapur vetëm 18 nga gjithsej 35 kapitujt dhe ka mbyllur përkohësisht vetëm dy. Në kapitullin 25 për Serbinë është vendosur edhe kushti për normalizimin gjithëpërfshirës të raporteve me Kosovën. Edhe në këtë raport përsëritet se "dinamika e përgjithshme e negociatave do të vazhdojë të varet në veçanti nga dinamika e reformave në sundimin e ligjit dhe normalizimi i raporteve të Serbisë me Kosovën".

Shqipëria bën përparim në gjyqësor

Shqipëria ka shënuar përparim të mirë në fushën gjyqësore teksa ka vazhduar zbatimin e reformës gjithëpërfshirëse gjyqësore, theksohet në raportin e progresit. Një prej arritjeve kryesore në gjyqësor konsiderohet emërimi i tre gjyqtarëve të rinj në Gjykatën Kushtetuese, që i ka mundësuar

të ketë kuorumin prej gjashtë gjyqtarëve në mënyrë që të mbajë mbledhje.

Sa i përket vettingut, raporti thekson se 62 për qind e rasteve që u janë nënshtruar vettingut kanë rezultuar ose në shkarkim apo largim nga puna.

KE-ja thotë se Shqipëria ka shënuar përparim në forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe ka bërë përparim të mirë në luftën kundër krimit të organizuar, duke shënuar rezultate të mira në këtë drejtim. Megjithatë, kritika ka sa iu përket sulmeve verbale, fushatave të shpifjes dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. "Tensionet ndërmjet aktorëve politikë dhe gazetarëve janë rritur gjatë pandemisë Covid-19 dhe në kontekstin e zgjedhjeve parlamentare", thuhet në raport. KE-ja, po ashtu, vë në pah se numri i azilkërkuësve në BE nga Shqipëria ka rënë për 66 për qind më 2020 krahasuar me vitin 2019, përkatësisht nga 20 415 në 6 935 azilkërkuës.

KE: Maqedonia e Veriut e përkushtuar për ta forcuar sundimin e ligjit

Sa i përket Maqedonisë së Veriut, Komisioni Evropian thotë se Shkupi ka vazhduar përpjekjet për ta forcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit përmes disa politikave kyçe dhe ligjeve. KE-ja vlerëson se kur kanë qenë në pyetje ligjet e lidhura me BE-në, ato kanë kaluar në parlament edhe me mbështetjen e opozitës. Sa i përket administratës publike që në të kaluarën ka qenë një prej kritikave kyçe të BE-së, KE-ja thotë se është bërë përparim në finalizimin e rishikimit funksional në administratën publike, por duhet bërë më shumë punë, veçanërisht në punësimin e njerëzve në administratë në bazë të meritave dhe jo për shkak të nepotizmit apo ndikimeve politike. Përparim është shënuar edhe në gjyqësi, ku përmendet zbatimi i strategjisë së gjyqësorit,

Kosova regjistron një viktimitë dhe 17 raste të reja me Covid-19

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të martën janë regjistruar 17 raste me Covid-19, pas testimit të 2 355 mostrave. Në 24 orët e fundit është regjistruar edhe një viktimitë. Autoritetet shëndetësore kanë thënë se më 19 tetor 86 persona janë shëruar derisa 562 persona janë ende aktivë me koronavirus. Prej shpërthimit të pandemisë në

mars të vitit 2020, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar mbi 160 000 raste të infektimit. Prej këtyre, 2 974 persona kanë vdekur. Prej nisjes së fushatës së vaksinimit 675 882 persona janë vaksinuar plotësisht kundër këtij virusi derisa 832 075 persona kanë marrë dozën e parë. Deri më 19 tetor në orën 15:00 është vaksinuar plotësisht 37.9 për qind e popullsisë së përgjithshme.



duke u bazuar në rekomandimet e Komisionit të Venecias. Progres, po ashtu, thuhet se është shënuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe luftimit të terrorizmit, megjithatë kërkohet ende të punohet në këtë drejtim. Maqedonia e Veriut, si shtet që po pret t'i nisë bisedimet me BE-në, në raport thuhet se këtë vit ka bërë përparim sa i përket sektorit të energjisë, veçanërisht në zbatimin e agjendës së gjelbër për të cilën, shtetet e Ballkanit Perëndimor u pajtuan gjatë Samitit të Sofjes në dhjetor të vitit 2020.

Në pjesën për Malin e Zi në Raportin e Progresit, vend kyç zënë tensionet dhe mosbesimi

ndërmjet aktorëve politikë. KE-ja thotë se polarizimi ndërmjet shumicës dhe opozitës ka qenë e pranishme gjatë tërë vitit 2020, por u shtua më shumë pas zgjedhjeve. Raporti thekson se Parlamenti në Mal të Zi duhet të dëshmojë se është i përkushtuar për agjendën e reformave evropiane. Raporti i KE-së nxjerr Bosnjë e Hercegovinën si vendin që ka shënuar më së paku përparim në shumë fusha. Në raport thuhet se ky shtet nuk ka bërë përparim në luftën kundër korrupsionit, lirisë së shprehjes, reformës zgjedhore, marrëdhënieve me jashtë si dhe ka pasur kthim prapa në fushën e prokurimit publik. (rel)

Vazhdojnë konsultimet për hartimin e strategjisë për mbrojtje nga dhuna në familje

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Nën organizimin e Ministrisë së Drejtësisë, gjegjësisht zëvendësministres së Drejtësisë, Nita Shala, njëherësh koordinatore kundër dhunës në familje, po vazhdon puna për hartimin e strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe planin e veprimit 2022-2026.

Në kuadër të këtij angazhimi, po realizohen takime dypalëshe me anëtarë të organizatave të shoqërive civile, drejtuese të strehimoreve në gjithë republikën, oficerë policie nga të gjithë stacionet policore në vend, të gjithë mbrojtësit e viktimave; të gjithë prokurorët e

caktuar që punojnë në raste të dhunës në familje dhe përfaqësues të emëruar nga kryesuesit e gjykatave të të gjitha niveleve në vend. Gjithashtu, do të zhvillohet takim konsultativ me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare e ambasadave të vendeve partnere. "Strategjia është mundësi e artë për të evidentuar aktivitete konkrete në zgjidhje të sfidave të evidentuara nga praktika dhe në parandalim e adresim efikas të dhunës në familje", është shprehur Shala. Takime të rregullta do të ketë përgjatë ditëve në vijim deri në finalizimin e plotë të një drafti ambicioz, me shumë potencial dhe gjithëpërfshirës.



Shantazhi i sërishëm përmes asociacionit

PRISHTINË, 19 TETOR - Pas fitores në nëntë komunat me shumicë serbe dhe shkuarjes në balotazh në një komunë, Lista Serbe ka dërguar mesazhe se mund të tërhiqet nga institucionet e Kosovës. Se mund të ndodhë një gjë e tillë, këtë e ka thënë kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, në rast se nuk do të ketë fillim të procesit për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Njohësja e zhvillimeve politike, Donika Emini, thotë se kërcënime dhe shantazhe nga Lista Serbe ndaj institucioneve politike të Kosovës, e sidomos qeverisë, ka pasur edhe më parë dhe ato në shumicën e rasteve kanë qenë kërcënime të zbrazëta. Por, megjithatë, siç thotë ajo, Qeveria e Kosovës duhet të jetë e vëmendshme në këtë pikë. Miodrag Marinković, drejtor i Qendrës për Veprime Shoqërore Afirmative nga Mitrovica e Veriut, thotë se është vështirë të përcaktohet nëse kërcënimi i Listës Serbe është i vërtetë apo është vetëm edhe një formë e presionit ndaj Qeverisë së Kosovës.

Në një konferencë për media, pas shpalljes së rezultateve preliminare të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit, Goran Rakiq e ka deklaruar fitoren e partisë së tij në të gjitha komunat, edhe pse komuna e Klllokotit do ta vazhdojë garën në balotazh për kryetar të komunës. "Po luftojmë për asociacionin e komunave me shumicë serbe. Në qoftë se nuk do të ketë asociacion, nuk do të ketë as institucione të Kosovës", ka thënë Rakiq, duke shtuar se kjo do të ndodhë në rast se bisedimet për asociacionin nuk do të nisnin deri në muajin e ardhshëm.

Por, drejtori i Zyrës për Kosovën i Qeverisë së Serbisë, Petar Petković, më 18 tetor ka deklaruar se në rast se nuk do të nisë formimi i asociacionit, "Lista Serbe dhe populli serb do të dalin nga të gjitha institucionet e Prishtinës në veri të Kosovës".



Emini: Vuçiqi synon krizën politike në Kosovë

Njohësja e zhvillimeve politike, Donika Emini, drejtore ekzekutive e platformës "CiviKos", në një bisedë me "Radion Evropa e Lirë" thekson se deklarata e kryetarit të Listës Serbe, Goran Rakiq, nuk është kërcënimi i parë i këtij lloji që vjen nga ky subjekt politik. Sipas saj, manovra e tyre politike është shantazh i vazhdueshëm ndaj institucioneve politike në Kosovë, kryesisht qeverisë. Por, sipas Eminit, përderisa në qeverisjet e kaluara Lista Serbe e ka pasur rehatinë që të dërgojë porosi kërcënuese, madje edhe kërcënime që kanë qenë të zbrazëta, ato kanë krijuar një lloj paniku për shkak se qeverisjet e kaluara kanë qenë të varura nga mungesa e numrave në kuvend dhe pjesëmarrja në qeverisje e Listës Serbe. Siç thotë Emini, tashmë një rast i tillë nuk është me qeverisjen e Lëvizjes Vetëvendosje e cila ka shumicën në Kuvendin e Kosovës si dhe qeverisë e vetme. Për më shumë, sipas saj, Lista Serbe nuk është ajo që vendos nëse Kosova do të ekzistojë si shtet ose nëse institucionet e saj do të ekzistojnë. "Nëse ai (Rakiq) e ka pasur fjalën në mënyrë specifike për institucionet e Kosovës në

komunat me shumicë serbe, atëherë kjo duhet të merret seriozisht, për faktin që (presidenti i Serbisë, Aleksandër) Vuçiq është në një pozitë të pafavorshme politike pas dy incidenteve në veriun e Kosovës. Normalisht që ai do të bëjë të pamundurën që të krijojë kriza politike në Kosovë apo të çojë mesazhe në Bruksel që marrëveshjet që janë arritur deri më tash në Bruksel, janë marrëveshje që nuk po zbatohen dhe kështu ta hedhë fajin te Prishtina", thotë Emini.

Ajo shton se që nga formimi i qeverisë në krye të së cilës është Albin Kurti, si dhe kthimit në dialog të Brukselit, presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka tentuar që ta ketë asociacionin e komunave me shumicë serbe si temë diskutimi, gjë të cilën Qeveria e Kosovës e ka refuzuar.

Kërcënimi i Listës Serbe, bluf apo i vërtetë?

Emini thekson se kërcënimet e kreut të Listës Serbe, Rakiq, mund të jenë një bluf por, sipas saj, Qeveria e Kosovës duhet ta ketë parasysh situatën e krijuar në veri të Kosovës pas dy intervenimeve të policisë atje, për vendosjen e masave të reciprocitetit për targa, si dhe për luftën kundër kontrabandës. Në intervenimin e

fundit, sipas saj, janë shënuar edhe sulme ndaj policisë, por edhe ndaj gazetarëve nga individë të caktuar në veri të vendit dhe, siç thotë Emini, kjo tregon se situata në veri është duke u përshkallëzuar.

Siç thotë Emini, në rast se deklarata e Rakiqit nuk është bluf dhe serbët braktisin institucionet e Kosovës, atëherë kjo mund t'i dëmtojë institucionet e vendit, por edhe raportet e institucioneve me qytetarët serbë që jetojnë në Kosovë. "I gjithë ky progres që është arritur deri më tash dhe ku Kosova ka investuar shumë, do të kthehet në pikën zero dhe kjo do ta dëmtojë pastaj edhe pozicionin tonë (të Kosovës) në Bruksel. Normalisht që kjo do të krijojë edhe probleme të tjera, ku në mënyrë potenciale komunat mund ta shpallin njëanshëm asociacionin e komunave me shumicë serbe, gjë që më pas, besoj se do të krijojë probleme të cilat mund të sjellin edhe incidente ndëretnike në Kosovë", shprehet Emini.

Ajo shton se në rast se realizohet kërcënimi i Rakiqit, përveç katër komunave veri, do të dezintegrohen edhe komunat me shumicë serbe në pjesën qendrore të Kosovës. E gjithë kjo situatë, sipas saj, është mesazh që Kosova duhet të përgatitet mirë për dialogun me Serbinë dhe që në rast se Kosova nuk e pranon formimin e asociacionit, atëherë duhet ta ketë një propozim që e zëvendëson atë marrëveshje ose të jetë e gatshme për ta negociuar sërish ose për ta hedhur poshtë atë.

Miodrag Marinković, drejtor i Qendrës për Veprime Shoqërore Afirmative nga Mitrovica e Veriut, konsideron që në këtë moment është shumë e vështirë të arrihet në përfundim nëse Lista Serbe me të vërtetë planifikon të largohet nga institucionet e Kosovës deri në fund të nëntorit, në qoftë se nuk fillojnë bisedimet për formimin e asociacionit të komunave me

shumicë serbe apo e gjithë kjo është një lloj presioni ndaj qeverisë së Albin Kurtit.

Siç thotë Marinković, Lista Serbe, Beogradi zyrtar dhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare po përpiqen që përmes metodave të ndryshme ta detyrojnë kryeministrin e Kosovës që të përfshihet në dialog me kapacitet të plotë, gjegjësisht që të pranojë një zgjidhje kompromisi për Kosovën.

"Në këtë kuptim, Beogradi ka shumë mekanizma për të vepruar sesa Bashkimi Evropian, sepse e kontrollon Listën Serbe në terren, ndërkaq Lista Serbe ka disa mekanizma me të cilat mund të çrregullojë veprimtarinë institucionale në Kosovë. Një prej tyre është tërheqja nga institucionet dhe kjo është e rëndësishme, sepse në Kosovë vendimet e rëndësishme merren me konsensus", thotë Marinković. Por, ai thekson se vendimi eventual i Listës Serbe për t'u tërhequr nga institucionet, në këtë kohë nuk do të ketë efekt të madh, sepse Albin Kurti ka një qeveri të qëndrueshme dhe, sipas tij, në skenën politike është e dukshme që "nuk ka lëvizje të planifikuar që do të kërkonin pjesëmarrjen e përfaqësuesve serbë".

Marinković shton që Beogradi, përmes Listës Serbe, në të vërtetë po e përdor çështjen e asociacionit për të bërë presion mbi Prishtinën, përkundër se është i vetëdijshëm që formimi i tij nuk është i mundur në aktualisht.

Siç thotë ai, "me veprimet e tilla Serbia po e shtyn Kosovën që ajo të jetë pala e cila do ta refuzojë zbatimin e marrëveshjes për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe", në mënyrë që dialogu ta humbë legjitimitetin, ndërkaq që presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, sërish ta përfitojë mundësinë që ta ngrehë çështjen e shkëmbimit territorial.

Zyrtarë të Bashkisë së Bajram Currit bëjnë homazhe te varri i veteranit të UÇK-së, Sylejmon Pepshi



JUNIK, 19 TETOR (ER) - Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së ish-luftëtarit të UÇK-së, Sylejmon Pepshi nga Juniku, të martën është bërë homazhe te varri i tij nga shumë qytetarë dhe dashamirë të tij.

Në shenjë respekti ndaj veprës së tij dhe kontributit dhënë për Kosovën, zyrtarë të Bashkisë së Bajram Currit dhe shumë qytetarë, si Ali Sylja, Shpend Bisheva, Ramë Gjoni, Hasan Buçpapaj, Ali Sallahi dhe Ilir Qela, kanë bërë homazhe në Junik duke nderuar veprimtarinë e Sylejmon Pepshit.

Ata janë pritur në familjen e Sylejmon Pepshit nga nënkryetari i komunës së Junikut, Faik Tofaj, komandanti i Policisë së Junikut, Rasim Sylja



dhe nga të afërm të tij. Në emër të delegacionit nga Bajram Curri ka folur Ali Sylja, i cili ka thënë fjalë të mëdha për veprën e Sylejmon Pepshit gjatë luftës së Kosovës.

Sylejmon Pepshin Bashkia e Bajram Currit në vitin 2015 e ka shpallur "Qytetar Nderi". Sylejmon Pepshi ka vdekur në moshën 78-vjeçare, më 19 tetor të vitit 2020.

Misioni BE-së: Vlerësime pozitive për zgjedhjet, përjashtuar komunat serbe

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 TETOR - Zgjedhjet komunale të 17 tetorit në Kosovë në përgjithësi janë vlerësuar pozitivisht, me përjashtim të komunave të banuara me shumicë serbe, ku konkurrenca politike ka qenë e kufizuar, ka vlerësuar Misioni Vëzhgues i Bashkimit Evropian (BE). Shefi i Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgim të Zgjedhjeve, Lukas Mandl, në një konferencë për media, të martën ka thënë se procesi zgjedhor është organizuar mirë dhe në mënyrë efikase. "Pluraliteti i kandidatëve ka ofruar për votuesit një zgjidhje të vërtetë, me përjashtim të komunave me shumicë serbe, ku konkurrenca politike ka qenë e kufizuar. E kemi parë që Lista Serbe e ka monopolizuar jetën politike të serbëve të Kosovës, madje ka pasur raste të kërcënimit dhe presioneve nga kandidatët e Listës Serbe dhe aktivistëve të tyre. Për fat të keq, gratë kanë qenë të nënpërfaqësuar në gara për kryetarë të komunave, financimi i fushatës nuk ishte transparentë", ka deklaruar Mandl, duke shtuar se ditën e zgjedhjeve vëzhguesit e BE-së kanë vizituar 400 vendvotime në nivel vendi. Ai ka thënë se votimi ka qenë i rregullt dhe i qetë

përkundër disa shqetësimeve të vërejtura në një numër të rasteve, siç ishte votimi me asistencë dhe votimi me dokumente të identifikimit me afat të skaduar.

Ndër të tjera, Mandl ka thënë se kuota gjinore prej 30-përqindësh është respektuar, por subjektet politike kanë nominuar vetëm disa gra kandidatë për kryetarë të komunave.

Edhe Viola von Cramon, raportuese për Kosovën në Parlamentin Evropian, ka përgëzuar qytetarët e Kosovës të të gjitha komuniteteve për ushtrimin e qetë dhe paqësor të së drejtës së tyre demokratike për t'i zgjedhur përfaqësuesit lokalë.

Fushata zgjedhore, sipas saj, ka qenë konkurruese dhe pa incidente madhore. "Këto zgjedhje komunale kanë dëshmuar se Kosova është një demokraci e vërtetë me një debat të vërtetë mes kandidatëve dhe partive politike që propozojnë politika alternative. Sot, më shumë se kurrë, Kosova është shembull në kuptim të pluralizmit dhe standardeve demokratike për rajonin", ka thënë Viola von Cramon.

Megjithatë, edhe ajo përmendi se në komunat e banuara me shumicë serbe në pjesën veriore



të Kosovës ka pasur presion nga Lista Serbe dhe aktivistët e saj. Zgjedhjet e 17 tetorit janë të dytat që janë organizuar në kohë pandemie.


Por, Viola von Cramon, tha se "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka arritur që në mënyrë efikase t'i zbatojë procedurat zgjedhore dhe nuk është vërejtur ndonjë parregullsi e madhe qoftë në periudhën parazgjedhore, qoftë në ditën e zgjedhjeve". Edhe organizatat joqeveritare që kanë monitoruar procesin e zgjedhjeve

të 17 tetorit kanë pohuar se janë vërejtur disa parregullsi, por të cilat nuk mund ta cenojnë integritetin apo besueshmërinë e zgjedhjeve. Disa nga parregullsitë e evidentuara, sipas tyre, kanë qenë votimi me asistencë, ushtrimi i presionit mbi votuesit si dhe prania e personave të paautorizuar në hyrje apo afërsi të qendrave të votimit. Sipas rezultateve preliminare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga 38 komunat ku janë zhvilluar, në 17 komuna janë

shënuar fitore të partive dhe 21 komuna do të shkojnë në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale në Kosovë.

Bazuar në rezultatet preliminare të KQZ-së, Lista Serbe ka fituar nëntë komuna, Partia Demokratike e Kosovës ka fituar pesë komuna, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës nga dy komuna, kurse Lëvizja Vetëvendosje nuk ka arritur fitore të qartë në asnjë komunë në raundin e parë.

Presidentja takon Auditoren: Paraja publike të menaxhohet si duhet



PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, ka prituri të martën në takim Auditoren e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, Vlora Spanca. Presidentja Osmani i ka uruar detyrën Spancës, duke i dëshiruar sukses në punë. Presidentja ka theksuar rolin e rëndësishëm të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe e ka inkurajuar Auditoren e Përgjithshme që të punojë në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies publike. Po ashtu, presidentja Osmani ka theksuar

nevojën e përbushjes së mandatit kushtetues e ligjor të ZKA-së, duke siguruar që paraja publike të menaxhohet si duhet. Në anën tjetër, Auditorja e Përgjithshme ka njoftuar presidenten lidhur me punën, aktivitetet dhe sfidat e ZKA-së. Spanca, po ashtu, ka ofruar edhe informata lidhur me bashkëpunimin e ZKA-së me institucione dhe organizata ndërkombëtare të auditimit si dhe ka theksuar rëndësinë e respektimit të legjislacionit vendor dhe praktikave ndërkombëtare në procesin e auditimit.

Në Klinikën e Radiologjisë kryhen 127 mamografi

Prishtinë, 19 tetor (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se që nga fillimi i tetorit, muajit të ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, që ndryshe njihet edhe si "Tetori Rozë", deri më tash në Klinikën e

Radiologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë kryer 127 mamografi. "Mamografia është një metodë radiologjike- incizim i gjirit në rëntgen, e cila përdoret për diagnostikimin e sëmundjeve të gjirit. Gjatë 9 muajve të këtij viti në kabinetin e shërbimeve të

mamografisë janë realizuar 1 489 mamografi. Klinika e Radiologjisë angazhohet që gratë të vetëdijesohen për sëmundjet e gjirit dhe të vijnë gjatë tërë vitit për kontrollime me mamografi, jo vetëm gjatë muajit tetor", ka njoftuar ShSKUK-ja.



Pozita dhe opozita përplasen në Kuvend për gazsjellësin

EPOKA E RE**Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 TETOR - Kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, janë përplasur me deputetët nga radhët e opozitës lidhur me projektin e gazsjellësit të financuar nga Zyra e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC).

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se paratë e dhëna nga MCC-ja janë të dedikuara për projektin e gazsjellësit.

Haradinaj gjatë seancës plenare që po mbahet në Kuvendin e Kosovës është shprehur se nëse nuk merren këto mjete financiare, atëherë qeveria duhet të presë edhe tre vjet të tjera. "Paratë janë dedikuara për gazsjellësin. Fillimisht projekti është 200 milionë euro për diversifikim të burimeve në energji. Pas tre vjetëve negociimi, të paktën dy qeverive Haradinaj dhe Hoti, ku këto para janë të dedikuara për gazsjellësin. Nëse nuk i merrni këto para, atëherë do t'i humbni edhe tri vjet të tjera për t'i marrë përsëri këto mjete", është shprehur Haradinaj.

Pas këtij deklarimi, kryeministri Kurti ka reaguar duke thënë se, nuk është e vërtetë që këto mjete janë ndarë për gazsjellësin. "Nuk është e vërtetë që këto para janë ndarë për gazsjellësin. Ne e kemi pasur rastin e 'Contour Global' sa iu përket aleancave. Është nënshkruar marrëveshja me 'Contour Global', nuk është ndrequr aleanca. Është prishur marrëveshja përsëri, nuk është ndrequr aleanca, sepse është shumë e fuqishme", ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se është gabim instrumentalizimi i ShBA-së për ta luftuar kryeministrin e vendit. "Është gabim instrumentalizimi i

ShBA-së për ta luftuar kryeministrin e Kosovës. Këtë e ka dëshmuar edhe populli. Pra, sa e doni ShBA-në tregon lehtësia që e instrumentalizoni atë kundër kryeministrin", ka shtuar ai.

Po në këtë seancë deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, ka thënë se vendimi i Qeverisë së Kosovës për gazsjellësin i dëmton rëndë interesat e vendit dhe ato gjeostrategjike. Ai është shprehur se nëse qeveria nuk e rishqyrton urgjentisht këtë vendim, Kosova mund të përfundojë si shteti i vetëm në rajon pa qasje në gaz.

Ndërsa Murati ka thënë se ka kaluar

koha për të fituar vota duke përmendur Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Murati duke iu përgjigjur Selmanajt lidhur me projektin gazsjellësit është shprehur se për këtë çështje është deklaruar agjencia amerikane.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka deklaruar më herët për media se fondet e ndara nga Zyra e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) nuk kanë qenë të dizajnuara për ndërtimin e infrastrukturës së gazit. Rizvanolli ka sqaruar se mundësitë e ndërtimit të këtij projekti ende ekzistojnë.



Kuvendi voton rialokimin e 2.3 milionë eurove nga marrëveshja financiare IPA 2017

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 TETOR - Deputetët e Kuvendit me 86 vota kanë miratuar Projektligjin për ratifikimin e amendamentimit numër një të marrëveshjes financiare IPA 2017 pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian përmes të cilit mundësohet rialokimi i shumës prej 2.3 milionë eurosh nga disa kontrata të pashpenzuara. Zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ka arsyetuar këtë projektligj derisa ka treguar se çka do të përfitohet me anë të saj.

Ai ka theksuar se qëllimi i amendamentimit të marrëveshjes në fjalë është që të mundësohet rialokimi i shumës prej 2.3

milionë eurosh nga disa kontrata të pashpenzuara dhe kursime në kuadër të veprimit të programit, përkatësisht instrumentit të përafritimit me Bashkimin Evropian dhe përmes kësaj të mundësohet kontraktimi i kësaj shume në kontrata ekzistuese brenda afatit kontraktual prej tri vjetëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes origjinale 22 tetor 2018. "Rialokimi do të shtojë 2.3 milionë euro në veprimin numër një të instrumentit të përafritimit dhe Bashkimin Evropian, nga veprimi numër dy mbështetja në pjesëmarrje të programeve të BE-së dhe atë në shumën e 300 mijë eurove, kurse nga veprimi numër tre, mbështetja e Bashkimit Evropian për përparësitë politike dhe dialogun për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit në



shumën e 1.9 milionë eurove dhe nga veprimi numër pesë mbështetja e Bashkimit Evropian për sistemin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Kosovë

0.1 milion euro", ka thënë Bislimi. Ai ka theksuar se shumata e marra nga këto projekte janë kursime dhe do të përdoren për ta mbështetur zbatimin e projekteve

të tjera siç është ndërtimi i filtrave të Kosovës B dhe për ndërtimin e shkollave të parapara me marrëveshjen financiare paraprake.

Kur do ta dëgjojmë fjalimin tjetër mbi Perden e re të Hekurt?



Nga Alan CALLOW
“Geopolitical Monitor”

Më 5 mars 1946, ish-kryeministri britanik Winston Churchill mbajti në Kolegjin Westminster në shtetin amerikan të Misurit, një fjalim të famshëm i cili shënoi fillimin e një përballjeje afatgjatë midis dy ideologjive konkurruese më dominuese në botë.

Në atë kohë kapitalizmi kaloi në një fazë aktive të “armiçësisë” kundër komunizmit. Më vonë, kjo përballje do të merrte titullin ogurzi “Lufta e Ftohtë”. Fjalimi i Churchill do të hynte në histori si “Fjalimi i Perdes së Hekurt”, duke i dhënë kështu emrin barrierës ideologjike që u ngrit midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX-të.

Tre vjet më vonë, 12 vende të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, krijuan një aleancë ushtarake dhe politike, synimi kryesor i së cilës ishte të frenonte ndikimin në rritje të Bashkimit Sovjetik.

Paralele historike

Në këtë rast ka shumë detaje interesante që lidhen me historinë e NATO-s. Për shembull, baza e partneritetit të Atlantikut të Veriut ishte Pakti i Brukselit (bashkimi i Belgjikës, Britanisë së Madhe, Luksemburgut, Holandës dhe Francës). Njëkohësisht, Shtetet e

Bashkuara, Kanadaja dhe Britania e Madhe zhvilluan negociata sekrete për krijimin e aleancës së tyre. Dhe në prillin e vitit 1949, u krijua aleanca më e fuqishme ushtarako-politike në botë. Pas 40 vjetësh, kjo aleancë ia doli të përmbushte me sukses qëllimin e saj kryesor: neutralizimin e Bashkimit Sovjetik.

Shumë njerëz thonë se historia është ciklike. Është e vështirë ta kundërshtosh këtë fakt, sidomos nëse sheh panoramën që po shpaloset sot në botë. Konfliktet midis sistemeve politike dhe ekonomive kryesore, janë pa asnjë dyshim një prirje e vazhdueshme në shekullin XXI. Gjithsesi, në këtë “film të ri” kanë ndryshuar paksa pjesëmarrësit në të: tani roli i personazhit negativ luhet nga Kina, ndërsa pjesa tjetër e skenarit mbetet shumë e njohur. Çifti i pandashëm Uashington-Londër, luajnë rolin e kampionëve të drejtësisë dhe ruajtjes së rendit aktual botëror. Gjithçka që po shohim i ngjan një ri-xhirimit të mirë të një filmi aksion dhe thriller me elementë të komedisë.

“Agresioni në rritje” si një arsye universale

Përshkrimi më i zakonshëm i politikës së Kinës gjatë viteve të fundit ka qenë fraza: “agresioni në rritje”. Natyrisht, rritja e agresionit nuk ndodh në një boshllëk. Shprehje të tjera të

ngjashme mund të gjenden shpesh në mediat kryesore botërore.

Shprehje të tjera të zakonshme janë “lufta tregtare”, “çështja e Tajvanit”, “problemi i ujgurëve”, dhe “territoret e diskutueshme”. Dihet mirë se çdo veprim i drejtpërdrejtë, do të provokojë herët a vonë konflikte, prandaj rruga më e natyrishtme e veprimit për vendet perëndimore dhe aleatët e tyre aziatikë, është krijimi i më shumë aleancave mbrojtëse dhe traktateve të sigurisë për të parandaluar agresionin e mundshëm nga Pekini.

Lojtarët më të shquar në këtë luftë të re për sundim botëror, fushëbeteja e së cilës gradualisht është zhvendosur nga Evropa Lindore në rajonin e Indo-Paqësorit janë: Traktati i Sigurisë Katërpalëshe (QAUD), që përfshin SHBA-në, Indinë, Australinë dhe Japoninë, si dhe AUKUS, i formuar nga SHBA-ja, Australia dhe Britania e Madhe më 15 shtator.

Për më tepër, aleancat e Uashingtonit me Tokion dhe Seul, i japin mundësi Shtëpisë së Bardhë që të vendosë mijëra ushtarë amerikanë në bazat e vendosura në territoret e partnerëve të saj aziatikë. Edhe pse arsyeja zyrtare për ekzistencën e këtyre organizatave është mbajtja e një rajoni të lirë dhe të hapur në Indo-Paqësor dhe zgjidhja e problemit bërthamor në Gadishullin Korean, një objektivi i pashprehur ka qenë frenimi i

fuqisë në rritje të Kinës.

Ndryshim i prioriteteve

Vendet e tjera në rajon që kanë interesat e tyre, janë të etura t'i bashkohen kësaj lojë të re. Për shembull, Singapori dhe Filipinet janë ekonomikisht të varura nga Kina. Por njëherazi të dyja shtetet e miratojnë qasjen politike të Uashingtonit për ta kundërshtuar Pekinin.

Në rajon ka edhe fansa të tjerë të politikës amerikane. Aftësia e Tajvanit për të mbetur relativisht sovran përballë pretendimeve territoriale të Kinës, lidhet direkt me mbështetjen e SHBA-së. Është po aq interesante të shihet ndryshimi i politikës tek vendet e tjera aziatike. Pavarësisht idealeve të tij komuniste, Vietnami, ka qenë gjithnjë e më i prirur të bashkëpunojë me SHBA-në dhe të shprehë kundërshtimin e tij ndaj axhendës kineze.

Ngjarjet e javëve të fundit, tregojnë qartazi se interesi i Uashingtonit për NATO-n po zbehet gradualisht. Përballë këtyre kërcënimeve dhe sfidave të reja, ky projekt historik po bëhet ekonomikisht jofitimprurës, dhe duket se Shtëpia e Bardhë ka vendosur të mos e fshehtë më apatinë e saj në rritje ndaj Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Prishja e kohëve të fundit e kontratës miliarda dollarëshe midis Parisit dhe Kanberës për projektimin dhe prodhimin e 12

nëndetëseve të reja për Marinën Australiane me nxitjen e SHBA-së, është një dëshmi e qartë e shpërfilljes së hapur të Uashingtonit ndaj një prej aleatëve kryesorë të saj në NATO, Francës.

Duke pritur “Fjalimin e ri të Perdes së Hekurt”

Në kohën kur u formua NATO për t'iu kundërvënë Bashkimit Sovjetik, organizata përbëhej nga 12 vende anëtare, të cila në një mënyrë a tjetër, kishin nënshkruar tashmë shumë marrëveshje dhe aleanca midis tyre. Sot, ka po aq vende të interesuara për krijimin e partneriteteve kundër kërcënimeve të mundshme nga Kina.

Sigurisht, mes tyre ka edhe mosmarrëveshje mbi disa çështje, por ata janë gjithmonë të solidarizuar mbi qëllimet e tyre parësore. Uashingtoni, Londra, Tokio, Kanbera, Nju Delhi, Seuli, Hanoi, Manila, Taipei dhe Singapori nuk janë të interesuara për hegjemoninë e “dragoiit” ekonomik dhe ushtarak kinez në Azi.

Prandaj ata do të bëjnë çdo përpjekje për ta parandaluar këtë gjë. Ndoshta në të ardhmen e afërt bota do të dëgjojë një “Fjalim të ri të Perdes së Hekurt”, dhe një analogjitë plotë dhe efektive e NATO-s që po vdes, do të shfaqet në rajonin Indo-Paqësor.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Llapi shkatërroi Ulpianën, fitojnë Prishtina dhe Drita

Prishtina, Llapi dhe Drita kanë shijuar fitore të martën në kuadër të javës së dhjetë në Superligën e Kosovës, pasi kanë mposhtur Malishevën, Ulpianën dhe Feronikelin. Sot (e mërkurë) zhvillohen dy ndeshjet e tjera të kësaj jave. Do të takohen Dukagjini - Ballkani dhe derbi Gjilani - Drenica



EPOKA ERE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 19 TETOR - Skuadra e Prishtinës ka marrë tri pikë shumë të rëndësishme nga përballja me Malishevën (2-1) e cila është zhvilluar të martën në stadiumin "Fadil Vokrri". Skuadra kryeqytetase ishte më e mirë në këtë ndeshje dhe me plot meritë arkitoi pikët e plota ndaj një skuadre që po arrin rezultate pozitive në Superligë. Besnik Krasniqi realizoi dy gola nga penalltia në pjesën e parë për rezultat 2-0. Malisheva u përpoq të rikthehet në lojë në pjesën e dytë, por e tëra që arriti ishte goli i Sobowale. Pas dhjetë xhirove, Prishtina është e pesta me 13 pikë, kurse Malisheva zë vendin e gjashtë me 12 pikë. Pas disa ndeshjeve pa fitore, nënkampionia e Kosovës në futboll, Drita, është këndellur dhe ka arritur të marrë tri pikë nga përballja me Feronikelin (0-2) në ndeshjen e javës së dhjetë të Superligës. Pjesa e parë e ndeshjes së zhvilluar në

stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas përfundoi pa gola 0-0, derisa në minutën e 51-të Marko Simonovski shënoi për mysafirët. Në minutën e 74-t Almir Ajzeraj realizoi për rezultat final 0-2. Pas kësaj fitore, Drita ngrehet në vendin e tretë me 16 pikë, kurse Feronikeli mbetet në kuotën e 10 pikëve. Skuadra e Llapit është treguar tepër e fortë për Ulpianën, pasi e mposhti me rezultat 0-6. Llapi shënoi tri gola në pjesën e parë të ndeshjes. Në minutën e 8 Valmir Veliu realizoi për 0-1. Golin e dytë e shënoi Idrizi në minutën e 21-të. Ndërsa për 0-3 është përkujdesur Ramadani. Valmir Veliu në fillim të pjesës së dytë realizoi për 0-4, kurse në minutën e 58 Kastriot Selmani e shënoi golin e pestë për llapjanët. Katër minuta para fundit të ndeshjes ka realizuar Gentrin Begolli. Llapi ngrehet në kuotën e 12 pikë, derisa mbetet i fundit me 7 pikë. Kjo fitore ishte e 100-ta për trajnerin Tahir Batatina si trajner i Llapit. "Fitoren e madhe sot ndaj Ulpianës me rezultat

0:6, të 100-tën jubilarë nën drejtimin e KF Llapit, ia dedikoj komandantit legjendar Zahir Pajaziti, të gjithë dëshmorëve të kombit, veteranëve dhe invalidëve të UÇK-së! Nga mali së bashku me ju, tash po shkruaj histori në liri me rininë e vendit tim", ka thënë Batatina. Në kuadër të javës së 10 në Superligën e Kosovës sot (e mërkurë) do të zhvillohen dy ndeshjet e radhës. Liderja aktuale, Drenica, i shkon Gjilanit. Të dyja këto skuadra do të synojnë rezultat pozitiv, kurse në ndeshjen tjetër në Klinë, Dukagjini e pret skuadrën e Ballkanit.

SUPERLIGA - Java 10

Feronikeli - Drita	0-2
Ulpiana - Llapi	0-6
Prishtina - Malisheva	2-1

Të mërkurën takohen:
 13:00 Dukagjini - Ballkani
 13:00 Gjilani - Drenica

SHKURT

'Dardanet' U19 i nisin me fitore kualifikimet për 'Euro 2022'

Përfaqësuesja e Kosovës U19 në konkurrencën e femrave e ka nisur në mënyrën më të mirë fushatën kualifikuese për "Euro 2022" në Pore të Kroacisë. "Dardanet" e reja të drejtuara nga Kushtrim Munishi të martën në mesditë kanë shënuar fitore në përballje me Letoninë me rezultat 3:0 në kuadër Grupit 5 të Ligës B. Kosova e dominoi plotësisht lojën dhe arriti të krijojë epërsi të hershme me golat e Leunora Xhemajt (2') dhe Erona Bajramit (13'). Edhe në vazhdim të ndeshjes "Dardanet" U19 arritën që pa ndonjë ngarkesë të madhe ta menaxhojnë mirë lojën dhe ta shënojnë edhe golin e tretë nëpërmjet Fortesa Berishës (70'). Ndeshjen e radhës Kosova e luan me Lihtenshtajnin më 22 tetor, kurse ndeshjen më të vështirë pritet ta ketë më 25 tetor kundër Kroacisë.

Shtyhet fillimi i edicionit në Ligën Unike të femrave

Edicioni i ri në Ligën Unike në konkurrencën e femrave është shtyrë deri më 24 nëntor 2021. Kjo vjen në pajtim me klubet dhe organizatorët e garave. Shorti u hodh të dielën në Shkodër, ku në xhiron e parë takohen Tirana - Prishtina, Flamurtari - Penza dhe Bashkimi - Partizani. Mesjavën e kaluar u zhvillua Superkupa Mbarëkombëtare te femrat, ku triumfoi Penza e Pejës. Edicioni i ri pritet të jetë interesant dhe rivalizues, duke marrë parasysh se gjashtë skuadrat shpresojnë të fitojnë në edicionin e parë të Ligës Unike. Ky është edicioni i parë dhe historik i Ligës Unike te femrat, ku marrin pjesë tri skuadra nga Kosova dhe tri nga Shqipëria.

Pique: Gjyqtarët japin më shumë faulle në favor të Barçës dhe Realit

Mbrojtësi i Barcelonës, Gerard Pique, tregohet më i sinqertë se sa duhet në një prononcim të dhënë së fundmi për kanalin e "Twitter" të Ibai Llanos. "Barcelona dhe Real Madrid janë dy klubet që marrin më shumë faulle në favor. Tani mund të them se është edhe Atletico. Me gjithë respektin që kam për klubet e tjera, nuk mund të krahasohen me ato për titull. Unë kërkoj drejtësi, që vlen njëloj për të gjithë, por kjo është e pamundur. Sigurisht, nuk mund të nervozohem, por në fund ne do të luftojmë për titull me klube si Real Madridi, Atletico Madridi dhe Sevilla", ka thënë qendërmbrojtësi i Barcelonës.

KOK-u dënon ashpër fyerjet antishqiptare në Banjallukë

Prishtinë, 19 tetor - Komiteti Olimpik i Kosovës ka pritur me shqetësim të madh fyerjet antishqiptare të tifozëve serbë në Banjallukë të Bosnjë e Hercegovinës, ku skuadra e hendbollit, Besa Fingas, u takua me Borcin, në kuadër të raundit të dytë të Kupës Evropiane të Hendbollit. Tifozët e Borcit fyen lojtarët tanë në baza të ulëta nacionaliste si: "Vritni, vritni shqiptarët!",

"Kosova është Serbi!", "Vritni, që shqiptarët mos të ekzistojnë!" etj. KOK-u dënon ashpër thirrjet e tilla, të cilat nxisin dhunë dhe urrejtje nacionaliste, e të cilat më së paku duhet të gjejnë vend në arenat sportive. KOK-u, njëherësh, kërkon nga organet përkatëse të Federatës Evropiane të Hendbollit, të marrin masa ndaj klubit të Borcit, në mënyrë që nxitësit e

dhunës ta marrin dënimin e merituar. "Po ashtu, përgëzojmë profesionalizmin dhe maturinë e shfaqur nga lojtarët e klubit Besa Fingas nga Peja të cilët nuk ranë pre e provokimeve të huliganëve serbë, ndërsa i inkurajon që në ndeshjen e kthimit që luhet në fundjavë në Pejë, t'u japim shembull të mikpritjes dhe kulturës sportive", thuhet në njoftimin e KOK-ut.



Crouch: Gerrardi fillimisht duhet të shkojë te Newcastle, pastaj në Liverpool

LIVERPOOL, 19 TETOR - Ish-sulmuesi i Liverpoolit, Peter Crouch, nuk ka dyshime mbi të ardhmen e Steven Gerrardit. Crouch ka folur për ish-kapitenin e Liverpoolit, tani trajner i Rangersit, në rubrikën e tij të "Daily Mail". "Kam shumë respekt

për Gerrardin. Kam luajtur me të te Liverpooli dhe ai ishte një lider i padiskutueshëm. Besoj se ka bërë një punë të jashtëzakonshme te Rangersi. Mendoj se Newcastle duhet të mendojë për të. Do të bënte të njëjtën punë që ka bërë

në Skoci, por me ndryshimin se te Newcastle do të kishte një buxhet më të mirë", ka thënë Crouch. Sipas ish-sulmuesit anglez, Gerrardi duhet fillimisht të shkojë te Newcastle e më pas në Liverpool. "Nga Newcastle mund

ta shohim te Liverpooli. Nuk mund të jetë ndryshe. Jurgen Kloppi nuk do të jetë përgjithmonë aty. Gerrard mund ta drejtojë klubin për 10 vjet dhe të bëhet një legjendë më e madhe", ka shtuar Crouch.



Sonte përballen Rahoveci - Trepça, nesër zhvillohen tri ndeshje

PRISHTINË, 19 TETOR - Java e shtatë e Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll do të zhvillohet në mesjavë. Takimi i vetëm i mërkurës është ndërmjet Rahovecit dhe Trepçës. "Vreshtarët" nuk e kanë nisur aq mirë kampionatin, ku në gjashtë xhiro kanë vetëm një fitore dhe pesë humbje, ndërsa mitrovicasit kanë katër fitore dhe vetëm një humbje në këtë edicion. Rahovecit kërkojnë këndelljen, kurse "Xehetarët" të vazhdojnë me formë të mirë. Bashkimi që ka tri fitore dhe tri humbje do të ndeshet



SUPERLIGA - Java 7

Të mërkurën takohen:
19:00 Rahoveci - Trepça

Të enjten takohen:
15:00 Bashkimi - RC Cola Drita
17:00 Sigal Prishtina - Prizreni 16
19:00 Peja - Golden Eagle Ylli

me RC Cola Dritën, që është skuadra e vetme në elitën e basketbollit të Kosovës që nuk ka shënuar asnjë humbje, duke pësuar gjashtë humbje në gjashtë ndeshje. Ndeshje shumë interesante shihet mes Sigal Prishtinës dhe Prizrenit 16. Prishtinasit kanë tri fitore dhe dy humbje, ndërsa prizrenasit katër fitore dhe dy humbje. Sfidat më

interesante është mes Pejës dhe Golden Eagle Yllit, dy finalistët e "play-off"-it të edicionit të kaluar, ku kishin fituar therandasit, që së fundi fituan në Superkupën Mbarëkombëtare në Ligën Unike. Pejanët janë në vendin e parë me pesë fitore dhe një humbje, kurse Ylli pas tri humbjeve, ka shënuar tri fitore në radhë.

Ademi: Jam sulmuar në mënyrë tinëzare, por nuk kam lëndime

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës në futboll (FFK), Agim Ademi, e ka konfirmuar se është sulmuar të martën në mëngjes në Gërmë. Ai ka thënë se në orën 08:00 është sulmuar nga persona të maskuar. "Duke pasur parasysh interesimin e madh të dashamirëve dhe të opinionit publik pas raportimit për sulm fizik ndaj meje, fillimisht dua t'ju informoj se jam mirë me shëndet dhe nuk bëhet fjalë për ndonjë lëndim siç është raportuar. Është e vërtetë që rreth orës 8:00 jam sulmuar fizikisht nga persona të maskuar në parkun e Gërmisë, aty ku çdo ditë e praktikoj ecjen dhe vrapimin në natyrë. Personat në fjalë më sulmuan në mënyrë tinëzare por që, fatmirësisht, kalova pa lëndime serioze", ka thënë Ademi.

Kryetari i FFK-së është zotuar se pengesat e këtij lloji nuk do të ndalojnë që të jetë në shërbim të futbollit të Kosovës. "Lidhur me



këtë rast është informuar edhe Policia e Kosovës, e cila tashmë është duke i kryer hetimet. Shpresoj dhe besoj se shumë shpejt personat e tillë do të dalin para organeve të drejtësisë dhe do të marrin dënimin e merituar. Përkundër

sfidave në punë, por edhe pengesave të këtij lloji, do të vazhdoj me tërë energjinë time t'i shërbej futbollit dhe ngritjes së mëtejme të FFK-së. Vazhdojmë me krenari e përgjegjësi!", ka shtuar Ademi.

SHKURT

Rooney mund të emërohet trajner i Newcastleit

Wayne Rooney mund të jetë trajneri i ardhshëm i Newcastle Unitedit dhe për këtë mund të largohet që në janar nga skuadra e Derby Countryt. Legjenda angleze është i interesuar ta drejtojë projektin e Newcastle Unitedit pas blerjes së klubit nga sheikët e Arabisë Saudite. Sipas mediave angleze, Rooney është i gatshëm ta drejtojë skuadrën angleze pas largimit të trajnerit aktual Steve Bruce, që pritet të shkarkohet së shpejti. Newcastle është vazhdimisht në kërkim të një trajneri që mund të marrë përsipër një projekt ambicioz, ku synohet të arrihen majat e futbollit.

Wilderi, gati të zhvillojë një duel të katërt me Furyn

Deontay Wilder është gati të zhvillojë një sfidë të katërt ndaj Tyson Furyt. Lajmin e konfirmoi Shelly Finkel, menaxheri i boksierit amerikan. Wilderi dhe Fury janë përballur tri herë mes tyre. Sfidat e parë përfundoi në barazim (dhjetor 2018), ndërsa në dy përballjet e tjera (shkurt 2020 dhe tetor 2021) britaniku Tyson Fury fitoi me KO. "Deontay është gati të zhvillojë një tjetër sfidë ndaj Furyt, i etur për një hakmarrje ndaj tij. Gjithsesi, kjo do të jetë e pamundur të zhvillohet, pasi njerëzit duan të shohin sfidat e tjera. Të shohim se çfarë do të ndodhë me revanshin mes Usyk e Joshua për të vendosur për të ardhmen e Wilderit, që mund të rezervojë të tjera surpriza", ka thënë Finkel.

Dybala - Juve, arrihet marrëveshja për rinovimin e kontratës

Më në fund Paolo Dybala dhe skuadra e Juventusit kanë gjetur akordin final për rinovimin e kontratës. Sipas "TuttoSport", agjenti i Dybala do të zbarkojë në Torino në fund të muajit për ta nënshkruar kontratën e re me "Zonjën e Vjetër". Gjithnjë sipas së përditshmes torineze, Dybala do të firmosë një kontratë që e mban të lidhur deri më 2026. Nga kjo kontratë sulmuesi argjentinas do të përfitojë 8,5 milionë euro kesh në vit plus 1,5 të tjera në formë bonusesh. Me Allegrin në stol dhe me largimin e Cristiano Ronaldos, Dybala është kthyer në qendër të projektit, tani edhe lojtari është i qetë dhe më i qartë për të ardhmen.

Conte shihet si zëvendësues i Solskjaerit

Trajneri Antonio Conte po përflitet çdo ditë e më shumë si një zëvendësues i mundshëm i Ole Gunnar Solskjaer. Skuadra e Manchester Unitedit ka pasur rezultate negative në tri ndeshjet e fundit në Premierë Ligë. Rezultate që mund të çojnë në largimin e trajnerit aktual të Unitedit, sepse në tre vjetet në drejtimit të "Djajve të Kuq" nuk ka arritur të sjellë asnjë trofe në "Old Trafford". Puna e Contes flet vetë. Një trajner kampion në Premierë Ligë, i cili udhëhoqi Chelsean drejt fitimit të kampionatit në vitin 2017 dhe për këtë drejtuesit e Unitedit e shikojnë të duhurin për stolin e skuadrës së tyre duke ditur që trajneri italian e njeh shumë mirë kampionatin anglez.

Tenistët e pavaksinuar nuk marrin pjesë në 'Australian Open'

Të gjithë tenistët që nuk kanë kryer vaksinën kundër Covidit nuk do të lejohen të luajnë në Grand Slam të "Australian Open", turneu i parë i madh që zhvillohet në janar të vitit 2022. Lajmin e konfirmoi

kryeministri i shtetit të Viktorias, Daniel Endrjus, ku ndodhet edhe qyteti i Melbourne, vendi ku zhvillohet kjo ngjarje. Kryerja e vaksinës prej disa javësh është bërë e detyrueshme për sportistët

profesionistë në mënyrë që ata të marrin pjesë në ngjarje. "Me shumë gjasë, asnjë tenist i pavaksinuar nuk do ta marrë vizën hyrëse për Australi për të luajtur në grand slam. Nëse ka nga ata tenistë që kanë vizë,

atëherë ata do të qëndrojnë disa javë në karantinë të detyrueshme. Ndërsa tenistët e vaksinuar do të jenë të lirë të luajnë", ka thënë Endrjus. Australia po përgatitet për t'i hequr të gjitha kufizimet për

herë të parë pas 18 muajsh, por çdo vendim që do të merret do të jetë gradual. Gjithçka do të varet nga vaksinimi i popullsisë dhe se si do të jetë situata në vendet e tjera.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 19.10.2021
 007/2021

Referenca: AAPSK -

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Hunday Accent,ngjyre e hirit e mbyllet-për skrap -Rishpallje	1 copë për skrap	268.24 €		
2	VW Caddy, viti i prodhimit 1998, dizel, ngjyrë e bardhe - për pjesë-Rishpallje	1 copë për pjesë	320.00 €		
3	Renault Twingo, viti i prodhimit 1999, benzin, ngjyre e kaltër me targa vendore	1 copë	650.00 €		
4	Fiat Punto, viti i prodhimit 2000, dizel, ngjyre e bardhe me targa vendore	1 copë	1,200.00 €		
5	VW Pasat Vento, viti i prodhimit 1992, ngjyre e kaltër. Nuk posedon dokumente qarkullimi por figuron te jetë i regjistruar	1 copë	300.00 €		
6	Mercedes Benz 124 200D, viti i prodhimit 1989, dizel, ngjyrë blu - për pjesë	1 copë për pjesë	400.00€		
7	Treper Machine WTJ-90A (pajisje për ngjitjen e shiritave)	1 copë	150.00 €		
8	TV Monitor Fuego Nr. Serik, 12384044906	1 copë	40.00 €		
9	TV Monitor JVC Nr. Serik, 11012533BV	1 copë	35.00 €		
10	TV Monitor LG Nr. Serik, 810MARZ39710	1 copë	60.00 €		
11	VW Golf II, viti i prodhimit 1984, benzin, ngjyre e hirit-për skrap	1 copë për skrap	239.89 €		
12	Mercedes 230D, viti i prodhimit 1986, dizel, ngjyre e bardhe-për skrap	1 copë për skrap	280.60 €		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 26.10.2021 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë. Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 26.10.2021, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

PËR SIGURINË E JUAJ DHE PUNONJËSVE TANË, JU LUSIM QË GJATË PJESËMARRJES NË ANKAND TË MBANI MASKËN KUNDËR COVID19; MBANI DISTANCËN DHE DEZINFEKTONI DUART RREGULLISHT!

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Royal Boutique” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr: 811302009,dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Royal Boutique” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr: 811302009, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Royal Boutique” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811302009 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
 KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LĚKARSKA KOMORA KOSOVA

Odela Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESE PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit: 06-21

Odela e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtarëve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe miron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Odela e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën Instituti A, Kati 2, QIKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin: Dosja për: Kontratë për furnizim me faksirail

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore:

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: 01.11.2021 ora 14:00.

Afati i fundit për aplikim në Tender është: 03.11.2021 ora 12:00.

Filapja e ofertave bëhet me datën: 03.11.2021 ora 14:00.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR ARSIM

Nr-4/11-6445
Datë: 19.10.2021

Në mbështetje të nenit 7 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020, Rregullores 15Nr. 670-47372 të datës 30.09.2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr. 670-55438 të datës 14.09.2021 për caktimin e numrit të bursave dhe shumës financiare për një bursë për studentë për vitin akademik-shkollor 2021/2022, Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit shpallë:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Komuna e Lipjanit ndanë 80 (tetëdhjetë) bursa për studentë të cilët studiojnë në Universitetet dhe Kolegjet e Republikës së Kosovës për vitin akademik 2021/2022. Vlera e bursës është 500 € për vitin akademik.

Kushtet dhe kriteret:

- Të drejtë për të aplikuar për bursë komunale kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - Të jenë banorë rezident të Komunës së Lipjanit,
 - Të jenë të regjistruar në vitin akademik për të cilin ndahen bursat,
 - Të kenë certifikatën e notave,
 - Të mos jenë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër për vitin e njëjtë akademik,
 - Të mos jenë të punësuar.
- Niveli i studimeve për të cilën ndahet bursa është themelore (bachelor), studentë aplikues duhet të jenë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve.
- Studentët do të vlerësohen me pikë nga Komisioni duke u bazuar në sukseset e arritura në vitin paraprak në pajtim me kriteret e përcaktuar me dispozitat e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020 dhe Rregullores 15Nr. 670-47372 të datës 30.09.2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020, në këto fusha të studimit:

Fakulteti i Arteve
Fakulteti i Shkencave Sportive.....
Fakulteti Juridik.....
Fakulteti Ekonomik.....
Fakulteti Filologjik.....
Fakulteti i Edukimit.....
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.....
Fakulteti Filozofik.....
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.....
Fakulteti i Mjekësisë.....
Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore.....
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.....

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Ekstraktin e lindjes
- Kopja e letërnjoftimit
- Certifikata mbi vendbanimin
- Deklaratën e bashkësisë familjare
- Certifikatën e notave
- ID e fakultetit
- Konfirmimin e llogarisë bankare
- Vërtetim nga fakulteti që nuk merrni bursë nga fakulteti
- Dokumentin zyrtar të lëshuar nga organi kompetent si dëshmi se është fëmijë i dëshmorit, invalidit, veteranit dhe martirit të luftës së UÇK, është person me aftësi të kufizuara, në asistencë sociale si dhe dëshminë se nuk i ka prindërit në jetë.
- Aplikacioni merret në zyrën e pranimit të Komunës dhe dorëzohet në këtë zyrë në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

Shënim:

- Të gjitha dokumentacionet e kërkuara duhet të jenë origjinale
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen

Shënim:

Rregulloren për Ndarjen e Bursave për Student mund ta gjeni në faqen e Komunës



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Isuf Zhegrova B.I me numër unik identifikues 811113860 shpall te pavlefshëm certifikatën e TVSH-se me numër 330180307

► Bernardina Alijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III,IV dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" drejtimi Farmaci Gjakovë.

► Xhevdet Dervishaj nga Nasheci i Prizrenit, shpall të pavlefshme Diplomën e studimeve themelore universitare të lëshuar nga Kolegji "Dardania", drejtimi: Banka, Financa dhe Kontabilitet.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN;
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales